



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 318, Datë 12.12.2022

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN NËNTOR 2022 PËR
KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/4 prot., datë 07.12.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Tetor 2022 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 8680 prot., datë 02.12.2022, protokolluar me tonën me nr. 2030 prot., datë 05.12.2022, shoqëria FSHU sh.a., ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin nëntor 2022, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Nga aplikimi i shoqërisë rezulton se çmimi i propozuar për muajin nëntor 2022 për këtë kategori klientësh është 31.30 lekë/kWh, ku përpos elementëve të çmimit të njohur nga “Metodologjia e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, shoqëria ka përfshirë sërish kostot e disbalancave.
- Rezultoni se në kërkesën e FSHU sh.a., reflektimi i kostove të disbalancave në çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga FMF, në kuptim të nenit 6, pika 3 dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin nr. 201 të bordit të ERE-s, datë 04.12.2017, e ndryshuar, tarifa që FMF do të aplikojë/ngarkojë tek klientët, do të përfshijë kostot për blerjen

e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e lëvrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori.

- Sikurse përcaktuar në metodologji, kostot e imbalancave (zë i emërtuar nga shoqëria si disbalanca) do të llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera në fuqi. Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, kostot e disbalancave nuk njihen si komponent i përlllogaritjes së çmimit të FMF.
- Mbështetur në nenin 9 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2022 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.
 - Në zbatim të vendimit nr. 74, datë 13.04.2022 të bordit të ERE-s, kostot administrative të përlllogaritura për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike nga shoqëria FSHU sh.a. për periudhën 1 Maj - 31 Dhjetor 2022, janë njohur në vlerën 1.06 lekë/kWh.
 - Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 Maj 2022 – 31 Dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 72, datë 13.04.2022, është 0.85 lekë/kWh.
 - Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 73, datë 13.04.2022, do të jetë 1.55 lekë/kWh.
- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, e ndryshuar, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2022, përlllogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin nëntor 2022</i>		
	Njësia	Çmimi
CBEt	çmimi i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh 26.94
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh 0.81
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh 1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh 0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh 1.55
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh 31.21

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:
 - Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *31.21 Lekë/kWh për muajin Nëntor 2022*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin Nëntor 2022, prej 31.21 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI